

zgj. - ond
Hes. v. endos
8.06.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 399/prot.
15

Tiranë, më 14.02.2024

Lënda: Dërgim Raport Auditimi

GJYKATËS SË SHKALLËS PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Durrës

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, në zbatim të Udhëzimit të MFE nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”, planit të auditimit për vitin 2024, të miratuar me Nr.5130/2 Prot. datë 5.10.2023, si dhe programit të angazhimit të auditimit Nr.399/1 Prot., datë 22.1.2024, realizoi angazhimin e auditimit me objekt: “Verifikimi dhe vlerësimi i monitorimit, mbi ecurinë dhe progresin e bërë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm”.

Bazuar në Ligjin Nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar dhe në Manualin e Auditimit të Brendshëm, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, po ju dërgojmë Raportin e Auditimit.

Bashkëngjitur do të gjeni Raportin e Auditimit dhe Pasqyrën Nr.2 “Verifikimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KRYETARE

Naureda Llagami



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORT AUDITIMI
PËR
GJYKATËN E SHKALLËS PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS

Tiranë, Shkurt 2024

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës funksionon në bazë të Ligjit Nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe ligjeve të tjera për administrimin publik.

Auditimi u krye në zbatim të Ligjit Nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, Kapitullit IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr.42, datë 27.10.2020 "Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik", planit vjetor të auditimit, të miratuar për vitin 2024 me nr.5130/2 Prot. datë 5.10.2023 dhe programit të angazhimit të auditimit nr.1, ref. nr.399/1, prot datë 22.1.2024.

Objekti i auditimit: Verifikimi dhe vlerësimi i monitorimit, mbi ecurinë dhe progresin e bërë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.

Qëllimi i auditimit: Dhënia e sigurisë objektive dhe të arsyeshme Titullarit mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të ngritura, nëse gjetjet nga auditimi i mëparshëm janë adresuar në mënyrën e duhur, rekomandimet e lëna janë zbatuar sipas afateve të miratuara dhe veprimet e ndërmarra nga gjykata janë zbatuar me efektivitet në realizimin e objektivave.

Periudha e auditimit: deri më 31.12.2023

Përmbledhja e rezultateve nga vlerësimi: Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është audituar nga DAB-ja në muajin Tetor të vitit 2023, për periudhën 1.7.2020 deri më 31.3.2023 dhe në raportin përfundimtar janë lënë 9(nëntë) rekomandime për zbatim. Gjykata ka reaguar në lidhje me rekomandimet e lëna në raportin e auditimit nëpërmjet pranimi të plotë të tyre, miratimin e planit të veprimit në të cilin ja caktuar personat përgjegjës dhe afatet për zbatimin e rekomandimeve. Nga vlerësimi i ecurisë dhe progresit që është bërë për zbatimin e 9(nëntë) rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, rezulton se janë zbatuar plotësisht 8 ose 89 %, në proces zbatimi (papërfunduar plotësisht) 1 ose 11 % dhe pa zbatuara, ska. Rekomandimet në proces zbatimi janë si më poshtë:

Rekomandimi nr.1: Për garantimin e rregullit e të sigurisë për zhvillimin normal të aktivitetit në gjykatë, të vazhdohet për gjetjen e një ambjenti të përshtatshëm që të garantojë elementët e sigurisë dhe ambiente të mjaftueshme e të përshtatshme pune për trupën gjyqësore, punonjësit e gjykatës, arkivën, ofrimin e një shërbimi cilësor për publikun bazuar në standardet e kërkuara. Deri në zgjidhjen e këtij problemi, të merren masat e duhura për garantimin e sigurisë në gjykatë.

Në lidhje me rekomandimin nr.1; Nga verifikimi rezulton se me shkresën nr 457/3 prot., datë 23.1.2024 të KLGJ, dërguar gjykatës është vendosur që godina e ish-Gjykatës së Apelit Durrës të kalojë në administrim të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Kalimi në përdorim i kësaj godine do të ndikojë në përmirsimin e kushteve të sigurisë dhe krijimin e ambienteve të mjaftueshme të punës por deri në këtë fazë nuk ka përfunduar riorganizimi gjykatës.

RAPORT AUDITIMI

Konkluzioni i përgjithshëm: Gjykata ka vlerësuar rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm dhe ka ndërmarrë hapa konkrete për zbatimin e tyre. Nisur nga fakti që shumica e rekomandimeve janë zbatuar dhe në proces zbatimi është 1(një) rekomandim, niveli i zbatimit të rekomandimeve është i mirë:

- Rekomandime të lëna 9.
- Rekomandime të zbatuara plotësisht 8 ose 89 %.
- Rekomandime në proces zbatimi (papërfunduar plotësisht) 1 ose 11%.
- Rekomandime të pazbatuara, ska.

Masat e marra për zbatimin e tyre kanë ndikuar në përmirësimin e funksionimit të veprimtarisë dhe arritjen e objektivave.

Në vijim të raportit në pikën 4 “*Vlerësimi i monitorimit, mbi ecurinë dhe progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm*”, jepet informacion i detajuar për çdo rekomandim.

2. HYRJE

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, u realizua auditim për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Baza Ligjore: Auditimi u krye mbështetur në dispozitat ligjore të mëposhtme:

1. Ligji Nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Ligji nr 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
5. Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
6. Ligji Nr.10296, datë 08. 07. 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.
7. Ligji nr. Nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.
8. Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 100, datë 25.10.2016, “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.
9. Udhëzimi i MFE nr.42, date 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”.

Për fillimin e angazhimit të auditimit, grupi auditimit në datën 1.2.2024, prezantoi qëllimin dhe drejtimet e auditimit dhe paraqiti kërkesën për dokumentacion (nr.557, prot. datë 1.2.2024) që duhet ti vihej në dispozicion grupit të auditimit deri në datën 1.2.2024.

Angazhimi i auditimit u krye nga grupi i auditimit të përbërë nga:

Z. Marjana Sulshabanaj	- auditues,
Z. Aristotel Telhaj	- auditues

Afati i Auditimit: 1.2.2024 - 2.2.2024.

RAPORT AUDITIMI

Grupi auditimit në datën 2.2.2024 mbas vlerësimit të dokumentacionit për progresin e zbatimit të rekomandimeve plotësoi pasqyrën nr. 2 “Verifikimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm për vitin 2023”, bashkalidhur këtij raporti.

3. METODA E AUDITIMIT

Në angazhimin e auditimit janë përdorur metoda dhe teknika auditimi si: intervistimi, krahasimi, leximi dhe studimi i raporteve, etj.

Dokumentacioni i verifikuar u përzgjedh me kampion sipas vlerësimeve të kryera për drejtimin e audituar.

Vlerësimi i kampioneve të dokumentacionit ju nënshtrua përputhshmërisë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe llogaritjeve të kryera nga punonjësit përkatës.

Kampionet u morën me teknikat e zgjedhjeve rastësore por dhe kohore dhe u shtrinë në të gjithë periudhën e auditimit, konkretisht: Listëpagesa, libra kontabël, urdhër shpenzime, shkresa e korespondenca të zhvilluara, vendime, urdhëra etj.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Gjatë auditimit si teknika auditimi u perdoren: sondazhet, përzgjedhja në mënyrë rastësore, kombinuar me teknika të tjera si kontrolli aritmetik (mandatet, librat e arkës, etj), shqyrtimi i dokumentave justifikuese e krahasimi me dokumentin bazë.

U vlerësua hartimi dhe zbatimi i plan veprimit mbi rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm.

Grupi i auditimit gjykoj se ky dokumentacion është i mjaftueshëm për të mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve.

4. Vlerësimi i monitorimit, mbi ecurinë dhe progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Në raportin përfundimtar të auditimit të mëparshëm, dërguar me shkresën Nr. 3737/5 prot, datë 18.10.2023 në gjykatë, janë lënë 9 rekomandime për zbatim.

Gjykata, ka reaguar nëpërmjet miratimit të planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar personat përgjegjës dhe afatin e zbatimit për çdo rekomandim. Plan i veprimit brenda afatit 30 ditor është dërguar pranë DAB-së me shkresën nr.6302 prot. datë 22.11.2023.

Në zbatim të Planit të Veprimit të miratuar nga zv/Kryetari i Gjykatës për cdo rekomandim të lënë, ka filluar ndjekja dhe zbatimi i tyre sipas personave/strukturave dhe afateve të caktuara.

Nga ana e grupit të auditimit u vijua me verifikimin në datat 1.2.2024 deri në datën 2.2.2024 në vend/gjykatë të veprimeve të ndërmarra sipas shpjegimeve dhe dokumentacionit justifikues/vërtetues të vënë në dispozicion nga gjykata.

Nga verifikimi, statusi i 9 rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezulton si më poshtë:

- **Rekomandime për përmirësimin e sistemeve**

Rekomandimi nr.1. Për garantimin e rregullit e të sigurisë për zhvillimin normal të aktivitetit në Gjykatë, të vazhdohet për gjetjen e një ambjenti të përshtatshëm që të garantojë elementët e sigurisë dhe ambjente të mjaftueshme e të përshtatshme pune për trupën gjyqësore, punonjësit e gjykatës, arkivën, ofrimin e një shërbimi cilësor për publikun bazuar në standardet e kërkuara. Deri në zgjidhjen e këtij problemi, të merren masat e duhura për garantimin e sigurisë në gjykatë.

RAPORT AUDITIMI

Niveli i riskut: I mesëm

Afati i zbatimit: Menjëherë

Statusi i rekomandimit: Në proces zbatimi (i papërfunduar plotësisht). Me shkresën nr 457/3 prot., datë 23.1.2024 të KLGJ dërguar gjykatës është vendosur që godina e ish-Gjykatës së Apelit Durrës të kalojë në administrim të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Kalimi në përdorim i kësaj godine do të ndikojë në përmirsimin e kushteve të sigurisë dhe krijimin e ambienteve të mjaftueshme të punës por deri në këtë fazë nuk ka përfunduar riorganizimi.

Rekomandimi nr.2. Struktura përgjegjese për menaxhimin e burimeve njerëzore, të marrë masa për sistemimin, inventarizimin dhe arkivimin e të gjithë procedurave të rekrutimit/ pranimit në punë të punonjësve, në dosje të veçanta, me të gjithë dokumentet/praktikën e krijuar që nga njoftimet/kërkesat/testimet/ankesat....etj,deri tek urdheri për fillimin e marrdhënies së punës.

Niveli i riskut: I mesëm

Afati i zbatimit: Menjëherë

Statusi i rekomandimit: Zbatuar plotësisht. Nga verifikimi rezulton se sektori i burimeve njerëzore ka inventarizuar, nëshkruar dhe arkivuar dosjet e rekrutimeve/pranimeve të reja.

Rekomandimi nr.3. Strukturat përgjegjese duhet të marrin masa për rishikimin e funksionimit sistemit të kontrollit të brendshëm në fushën e pagave:

- Duke përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës që merret me procedurat e sistemit të pagave.

- Listëpagesat të plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listeprezenca). Në përfundim të procesit të hartimit listëpagesat të nënshkruhen nga punonjësi i caktuar për pagat, kontrollohen dhe nënshkruhen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore.

- Duke përmirësuar formatin e listepageses me të gjithë elementet e saj referuar standartit të miratuar në legjislacionin në fuqi.

- Nëpunësi zbatues para miratimit të listëpagesave të sigurohet në lidhje me rregullshmërinë e jashtme, kontrollin nga pikpamja e zbatimit të ligjshmërisë dhe kontrollin e saktësisë së veprimeve aritmetike.

Niveli i riskut: I mesëm

Afati i zbatimit: Menjëherë

Statusi i rekomandimit: Zbatuar plotësisht. Nga verifikimi rezulton se listpagesat janë hartuar nga punonjësi i caktuar për pagat(*specialisti financës caktuar me urdhërin nr.181 datë 27.10.2023*) mbi bazën e listprezencës dhe nëpunësi zbatues. Nga burimet njerëzore nuk është nënshkruar pasi ka filluar punë në Janar 2024 dhe reflektimi do kryhet për listpagesat që paguheshin në muajin shkurt 2024.Listpagesat janë hartuar në përputhje me standardin e miratuar në udhëzimin nr.1 datë 21.5.2021 të MFE .

Rekomandimi nr.4. Këshilli i gjykatës të marrë masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në sektorët që kanë lidhje me përlllogaritjen dhe arkëtimin e tarifës gjyqësore duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës, si dhe mënyrën e mbikqyrjes dhe monitorimit të këtij procesi..

Niveli i riskut: I mesëm

Afati i zbatimit: Menjëherë

Statusi i rekomandimit: Zbatuar plotësisht. Nga verifikimi fizik në sekretari rezulton ne tarifa gjyqësore është aplikuar drejt dhe për arkëtimin e saj është ngarkuar punonjësi që kryen detyrën e arkëtares në zbatim të urdhërit brendshëm nr.154 prot datë 27.9.2023 të Zv/Kryetarit Gjykatës.

Rekomandimi nr.5. Nëpunësi Autorizues të marrë masa për ndërprerjen e pagesës/ parapagimit nga fondet buxhetore të shpenzimeve gjyqësore për procese gjyqësore civile që paguhen nga palët në proces dhe përpara marrjes së angazhimeve buxhetore dhe kryerjes së pagesave duhet të sigurohet se është kryer kontrolli që garanton ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e përdorimit të fondeve buxhetore.)

Niveli i riskut: I mesëm

Afati i zbatimit: Menjëherë

Statusi i rekomandimit: Zbatuar plotësisht. Nga verifikimi i i Urdhër Shpenzimeve rezulton se nuk është kryer asnjë pagesë e kësaj natyre në favor të ASHK Durrës. Njëkohësisht nga verifikimi në sistemin e menaxhimit të faturave e lektronike rezulton faturat e kësaj natyre janë me status refuzuar nga muaji Tetor 2023 e në vijim.

Rekomandimi nr.6. Nëpunësi Autorizues në mungesë pozicionit të punës "arkëtar" të marrë masa për të caktuar me urdhër të brendshëm një punonjës tjetër të gjykatës për kryerjen e detyrës së arkëtarit i cili duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara ligjore të punonjësit me përgjegjësi materiale. Nëpunësi Zbatues të marrë masa për mbajtjen e librit të arkës në përputhje me rregullat kontable, prerjen e m.arkëtimeve dhe m.pagesave(veprimeve cash) dhe regjistrimin në kontabilitet në momentin e ndodhjes së veprimit financiar.

Niveli i riskut: I mesëm

Afati i zbatimit: Menjëherë

Statusi i rekomandimit: Zbatuar plotësisht. Me urdhërin nr.154 prot datë 27.9.2023 është caktuar punonjësi që kryen detyrën e magazinierit, për kryerjen edhe të detyrës së arkëtarit. Njëkohësisht është mbajtur libri i arkës dhe prerja e m.arkëtimeve dhe m.pgesave është realizuar në momentin e ndodhjes së veprimit nga muaji Tetor 2023 e në vijim.

Rekomandimi nr.7. Çdo lëvizje e brendshme e aktiveve nga një zyrë/punonjës në një zyrë/punonjës tjetër të kryhen me autorizim të personit të caktuar nga nëpunësi autorizues (kancelari); të dokumentohen menjëherë lëvizjet dhe të informohet nëpunësi zbatues me qëllim pasqyrimin në kontabilitet në kohën e ndodhjes së tyre.

Niveli i riskut: I mesëm

Afati i zbatimit: Menjëherë

Statusi i rekomandimit: Zbatuar plotësisht. Lëvizja e aktiveve është shoqëruar me urdhër dorëzimi të lëshuar nga kancelarja e gjykatës.(U.Dorzimi dt.1.10.2023) dhe pasqyruar në kartelën personale të çdo punonjësi që ka tërhequr aktive nga magazina apo lëvizje ndërmjet zyrave.

Rekomandimi nr.8. Të përditësohet regjistri aktiveve me të dhënat mbi kohën reale të hyrjes në përdorim të aktiveve; vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes së tyre. Të plotësohen të dhënat specifike (si lloji, marka, numri serial, kodi etj) në inventarin kontabël të pajisjeve elektronike që janë në përdorim nga punonjësit e gjykatës për ti bërë të dallueshme ato nga njëra tjetra dhe për të siguruar përputhje midis tyre dhe të dhënave të gjendjeve fizike dhe mos tjetërsim të tyre.

Niveli i riskut: I mesëm

Afati i zbatimit: Deri në Dhjetor 2023

Statusi i rekomandimit: Zbatuar plotësisht. Nga verifikimi rezulton se nga nëpunësi zbatues është hartuar regjistri i aktiveve në exel dhe është përditësuar me të dhënat e përcaktuara në udhëzimin nr 30 datë 27.12.2011''Për menaxhimin e aktiveve në Nj.S.P. të ndryshuar.

RAPORT AUDITIMI

Rekomandimi nr.9. Të mbahet e të saktësohet evidenca mbështetëse analitike në llogaritjen e amortizimit për aktivet afatgjata ndër vite, vecmas dhe mbi bazë grupimi sipas normave të amortizimit dhe kriterëve të përcaktuara në pikën nr.36 Kreu III-të të Udhëzimit nr.8 datë 19.3.2018, i ndryshuar dhe vlerat neto që rezultojnë pas zbritjes së amortizimit të akumuluar të krahasohen me ato të pasqyruara në bilance dhe në raste diferencash të bëhen sistemimet kontable përkatëse në bilancin e vitit aktual ushtrimor.

Niveli i riskut: I mesëm

Afati i zbatimit: Deri në Shkurt 2024

Statusi i rekomandimit: Zbatuar plotësisht. Nga verifikimi rezulton se nga nëpunësi zbatues është hartuar dhe saktësuar amortizimi i çdo aktivi afatgjatë janë llogaritur vlerat neto të tyre. Tabela e amortizimeve është hartuar në exel

Opinion i përgjithshëm: Gjykata ka vlerësuar rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm. Masat e marra për zbatimin e tyre kanë ndikuar në përmirësimin e funksionimit të veprimtarisë dhe arritjen e objektivave. Duhet të vazhdohet me monitorimin, ndjekjen dhe zbatimin e plotë të 1(një) rekomandimi që është në proces zbatimi (të papërfunduara plotësisht).


Rezultatet e verifikimit janë pasqyruar në Pasqyrën nr.2 bashkëlidhur raportit.

Raporti Auditimit hartohet në 3 (tre) kopje, nga 1(një) kopje administrohen nga DAB-ja, dhe zyra e protokollit dhe 1 (një) kopje i dërgohet gjykatës.

Grupi i Auditimit

Aristotel Telhaj

Marjana Sulshabanaj



Njësia e Auditimit të Brendshëm në KLGJ

Verifikimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm për vitin 2023
Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Pasqyra nr.2

1	2	3	4	5	GJETJET			7	8	9	10
Viti i kryerjes së auditimit	Subjekti i audituar	Data e Raportit Perfundimtar të Auditimit	Lloji i Auditimit	Sistemi /Fusha	Nensistemi	Niveli i Riskut	Pwrgjigja e subjektit	Afati i implementimit te rekomandimit	Satusi Rekomandimit		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10		
2023	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	Nr.3737/5 prot,datë 18.10.2023	I Kombinuar								
1	Për garantimin e rregullit e të sigurisë për zhvillimin normal të aktivitetit në Gjykatë, të vazhdohet për gjetjen e një ambienti të përshatshëm që të garantojë elementët e sigurisë dhe ambiente të mjaftueshme e të përshatshme pune për trupën gjyqësore, punonjësit e gjykatës, arkivën, ofrimin e një shërbimi cilësor për publikun bazuar në standardet e kërkuara. Deri në zgjidhjen e këtij problemi, të merren masat e duhura për garantimin e sigurisë në gjykatë.		Auditimi i përputhshmërisë	1 Qeverisja dhe administrimi	1.4.Siguria fizike	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi te zbatohet menjhere	Ne proces zbatimi por i paperfunduar plotesisht		
2	Struktura përgjegjese për menaxhimin e burimeve njerëzore, të marrë masa për sistemin, inventarizimin dhe arkivimin e të gjithë procedurave të rekrutimit/ pranimit në punë të punonjësve, në dosje të veçanta, me të gjithë dokumentet/praktikën e krijuar që nga njohimet/ kërkesat/testimet/ankesat.....etj,deri tek urdheri për fillimin e marrdhënies së punës.		Auditimi i përputhshmërisë	4 Menaxhimi Burimeve Njerëzore	4.7 Administrimi dosjes personale dhe regjistrat themeltar	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi te zbatohet menjhere	Zbatuar Plotesisht		
3	Strukturat përgjegjese duhet të marrin masa për rishikimin e funksionimit sistemit të kontrollit të brendshëm në fushën e pagave: - Duke përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës që merret me procedurat e sistemit të pagave. - Listëpagesat të plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listeprezenca). Në përfundim të procesit të hartimit listëpagesat të nënshkruhen nga punonjësi i caktuar për pagat, kontrollohen dhe nënshkruhen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore. - Duke përmirësuar formatin e listepageses me te gjithë elementet e saj referuar standartit të miratuar në legjislacionin në fuqi. Nëpunësi zbatues para miratimit të listëpagesave të sigurohet në lidhje me rregullshmërinë e jashtme, kontrollin nga pikpanja e zbatimit të ligjshmërisë dhe kontrollin e saktësisë së veprimeve aritmetike.		Auditimi i përputhshmërisë	5 Pagat dhe shperblimet	5.1.Perlogaritja e pagave	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi te zbatohet menjhere	Zbatuar Plotesisht		

4	Këshilli i gjykatës të marri masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në sektorët që kanë lidhje me përlogaritjen dhe arkëtimin e tarifës gjyqësore duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës, si dhe mënyrën e mbikqyrjes dhe monitorimit të këtij procesi.	Auditimi i përputhshmërisë	9. Të Ardhurat nga Tarifa Gjyqësore	9.1 Saktësia e përlogaritjes së tarifës gjyqësore	I mesem	Pranuar plotësisht	Rekomandimi të zbatohet menjëherë	Zbatuar plotësisht
5	Nëpunësi Autorizues të marrë masa për ndërprerjen e pagesës/ parapagimit nga fondet buxhetore të shpenzimeve gjyqësore për procese gjyqësore civile që paguhen nga palët në proces dhe përpara marrjes së angazhimeve buxhetore dhe kryerjes së pagesave duhet të sigurohet se është kryer kontrolli që garanton ligshmërinë dhe rregullshmërinë e përdorimit të fondeve buxhetore.	Auditimi i përputhshmërisë	6 Raportimi Financiar dhe Kontabiliteti	6.3 Pagesat	I mesem	Pranuar plotësisht	Rekomandimi të zbatohet menjëherë	Zbatuar plotësisht
6	Nëpunësi Autorizues në mungesë pozicionit të punës "arkëtar" të marrë masa për të caktuar me urdhër të brendshëm një punonjës tjetër të gjykatës për kryerjen e detyrës së arkëtarit i cili duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara ligjore të punonjësit me përgjegjësi materiale. Nëpunësi Zbatues të marrë masa për mbajtjen e librit të arkës në përputhje me rregullat kontable, prirjen e m.arkëtimeve dhe m.pagesave(<i>veprimeve cash</i>) dhe regjistrimin në kontabilitet në momentin e ndodhjes së veprimit financiar.	Auditimi i përputhshmërisë	6 Raportimi Financiar dhe Kontabiliteti	6.6 Rregjistrimet në kontabilitet	I mesem	Pranuar plotësisht	Rekomandimi të zbatohet menjëherë	Zbatuar plotësisht
7	Çdo lëvizje e brendshme e aktiveve nga një zyrë/punonjës në një zyrë/punonjës tjetër të kryhen me autorizim të personit të caktuar nga nëpunësi autorizues (kancelari); të dokumentohen menjëherë lëvizjet dhe të informohet nëpunësi zbatues me qëllim pasqyrimin në kontabilitet në kohën e ndodhjes së tyre.	Auditimi i përputhshmërisë	7 Aktivet e Qendrueshme	7.3 Saktësia	I mesem	Pranuar plotësisht	Rekomandimi të zbatohet brenda 6 muajve	Zbatuar plotësisht
8	Të përditësohet regjistri aktiveve me të dhënat mbi kohën reale të hyrjes në përdorim të aktiveve; vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes së tyre. Të plotësohen të dhënat specifike (si lloji, marka, numri serial, kodi etj) në inventarin kontabël të pajisjeve elektronike që janë në përdorim nga punonjësit e gjykatës për ti bërë të dallueshme ato nga njëra tjetra dhe për të siguruar përputhje midis tyre dhe të dhënave të gjendjeve fizike dhe mos tjetërsim të tyre.	Auditimi i përputhshmërisë	7 Aktivet e Qendrueshme	7.3 Saktësia	I mesem	Pranuar plotësisht	Rekomandimi të zbatohet menjëherë	Zbatuar plotësisht

9 llogaritjen e amortizimit për aktivet afatgjata ndër vite, vecmas dhe mbi bazë grupimi sipas normave të amortizimit dhe kriterëve të përcaktuar në pikën nr.36 Kreu III-të të Udhëzimit nr.8 datë 19.3.2018, i ndryshuar dhe vlerat neto që rezultojnë pas zbritjes së amortizimit të akumuluar të krahasohen me ato të pasqyruara në bilance dhe në raste diferencash të bëhen sistemitet kontable përkatëse në bilancin e vitit aktual ushtrimor.

2021	Rekomandime te pazbatuara nga auditimi meparshem	Nr.760 Prot. datë 15.2.2021
1	Gjykata për të rritur sigurinë fizike dhe llogjike në dhomën e serverit në drejtim të uljes së riskut të aksesit të paautorizuar, vendosjes së sistemeve të mbrojtjes e sinjalizimit. Të marrë masa për përmirësimin e kushteve në dhomën e serverit, duke analizuar dobësitë të hartohet një plan veprimi në përputhje me specifikimet në rregulloren e AKSHIT "Mbi ndërtimin e dhomës së serverit" dhe të kërkohet fondi përkatës në organin qendror.	

Grupi i Auditimit

Aristotel Telhaj

Marjana Sulshabanaj

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të
Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Zv.Kryetar

Pauli Çera

Kancelare

Viola Kondo

Përgj.Sekt.Buxh.&Menaxh.Financiar

Marsida Arkaxhiu

Përgj.Sekt. Burimeve Njerezore,
Sherbimeve Mbeshtetese dhe
Prokurimeve

Entila Kasa

Auditimi i përputhshmërisë	7 Aktivet e Qendrueshme	7.6. Amortizimi	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi te zbatohet brenda 6 muajve	Zbatuar Plotesisht
Auditimi i përputhshmërisë	10.Sistemi IT	10.2.Kushtet dhe Standartet	I mesem	Pranuar plotesisht	Rekomandimi te zbatohet brenda nje viti	Pa zbatuar